



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.138/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konushevcu dhe Faton Ademi anëtarë, me zyrtarin ligjor Bajram Rexhahmetaj, duke vendosur përkitazi me ankesën e koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër Lëvizjes Vetëvendosje(LVV), dega në Gjilan, për shkak të vendosjes së postereve në shtyllën publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 09.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**Pranohen** si te bazuara ankesat Anr.138/2017 dhe Anr.145/2017 të datës 07.06.2017, te koalicionit PDK-AAK-NISMA, me seli në Prishtinë, dhe subjekt politik Lëvizjes Vetëvendosje, dega në Gjilan, i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 2,100.00 (dymijë e njëqind) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

### A r s y e t i m

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar dy ankesa nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, ankesën Anr.138/2017 dhe Anr.145/2017 në të cilat pretendohet se me datën 07.06.2017 aktivistët e koalicionit PDK-AAK-NISMA kanë vërejtur se në Parkun e Qytetit afër shkollës “Themë Mitko” dhe afër xhamisë së madhe në qytetin e Gjilanit, aktivistët e tyre kanë vërejtur se në shtylla elektrike ishin të vendosur posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pikës b e Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së, dhe konsideron se vendosja e materialeve zgjedhore në objektet publike përbën veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët apo mbështetësit e tyre. Ankuesit në mbështetje të pretendimeve në ankesën Anr 138/2017, si provë lidhur me rastin në fjalë kanë bashkangjitur 2(dy) fotografi të printuara dhe ankesa Anr.145/2017, i ka bashkangjitur 1(një) fotografi të printuar.

Më datën 07.06.2017 në ora 18:50 PZAP-i i dërgoi kërkesë dhe urdhër përmisim subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje në bazë të ankesës së bërë nga ana e koalicionit PDK-AAK-NISMA me të iu dha afati për përgjigje deri më datën 08.06.2017.

Më datë 08.06.2017, PZAP-i pranoi kërkesë për tërheqje të ankesës me numër Anr. 121/4 të datës 07.06.2017, nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA, për tërheqjen e të gjitha ankesave të parashtruara ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje për të cilat PZAP-i nuk ka marrë vendim përfundimtar.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 8.3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, ka bashkuar ankesat e lartcekura dhe i trajton si një ankesë evidentuar me Anr.138/2017 për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve, dhe për të dy ankesat i vendosi me një vendim për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par.2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e bazuar**

Paneli vlerëson nga fotografit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës shihet qartë se posterat e kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është i vendosur në shtyllë publike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33, pika b), të LZP-së e cila përcakton: “ *Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në apo mbi rrugët publike*”.

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteret e kandidateve për deputet nga subjekti në fjalë, janë vendosur në shtyllë elektrike publike.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, kanë marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se shkelja e njëjtë nga subjekti politik LVV, është përsëritur disa herë në këtë proces zgjedhor, ku për kundër këtij fakti posterat e kandidatëve për deputet nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, janë vendosur në shtyllë elektrike.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, e datës 09.06.2017, për tërheqjen e ankesave Anr.138/2017 dhe Anr.145/2017, të datës 07.06.2017, e parashtruar ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njërës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në neni 54 par.1 të Ligjit për Procedurën Administrative është parashikuar që “Tërheqja e njërës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në procedim”. Paneli nuk e bëri lejjimin e tërheqjes së ankesës sepse ka vlerësuar se veprimi i subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, ka cenuara interesin e publikut kjo aq më tepër kur kërkesës nuk iu ka shoqëruar asnjë provë në bazë të cilave do të dëshmohej se është bërë riparimi i shkeljes në teren, duke i tërhequr posterat nga vendi i palejuar, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Andaj, duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 32 par.2, nenit 118 par.1 dhe nenit 120 par.1 pika (c) të LZP-së, lidhur me nenin 51.4 të LPA-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 138/2017 më datën 09.06.2017



**Kryesuesi i Panelit  
Rafet Haxhaj**

***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.***